

Leonard XHAMANI  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja  
Tiranë, SHQIPËRI  
e-mail: [leonardxhemani@hotmail.com](mailto:leonardxhemani@hotmail.com)

**NDËRTIMI KALLËZORE ME PASKAJORE E GJUHËS LATINE DHE  
PËRKTHIMI I SAJ NË SHQIPE  
THE ACCUSATIVE WITH INFINITIVE OF THE LATIN LANGUAGE  
AND ITS TRANSLATION INTO ALBANIAN**

## Hyrje

Kallëzorja me paskajore (*accusativus cum infinitivo*) e latinishtes është ndër ndërtimet më interesante në këtë gjuhë. Në këtë ligjëratë do të mundohemi të japim rastet e këtij ndërtimi dhe përkthimet përkatëse duke i ilustruar me shembuj të marrë nga autorët latinë. Në vetvete ky ndërtim paraqet një fjali të varur kundrinore (ose një kundrinë të drejtë të përbërë), në të cilën kryefjala logjike gjendet në kallëzore, ndërsa folja shprehet me anë të paskajores. Për shembull:

Video discipulos scribere – Shoh që nxënësit shkruajnë. (Qiriazati – Dish-nica 1990: 280)

Discipulos – është kryefjala logjike në rasën kallëzore.

Scribere – është folja e shprehur me paskajore.

Një ndërtim i tillë në shqipe në pjesën më të madhe të rasteve ka ardhur i zërthyer me anë të një fjalie të varur kundrinore, ku kundrinori i fjalisë së nënrenditur kthehet në kryefjalë dhe paskajorja në folje në mënyrën dëftore ose lidhore. *Accusativus cum infinitivo* përdoret në gjuhën latine në fjalitë paskajore me vlerë kundrinore, gjithsesi më të theksuara rastet e këtij ndërtimi janë si më poshtë:

## 1. Foljet e perceptimit

Foljet që shprehin një perceptim, si: *video* = shoh, *aspicio*, *conspicio*, *animadverto* = shikoj, vërej, *invenio* = gjej, *audio* = dëgjoj, etj., kanë pas vetes kallëzoren dhe paskajoren, nëse tregojnë gjendjen e faktit që pason veprimin. Për shembull:

Sed ubi certis auctoribus *comperit* minus V et XX milibus longe ab Utica eius **copias abesse**, relictis munitionibus...

Por, kur nga burime të sigurta *mësoi* se **ushtarët** nuk **ishin** më pak se 25 milje nga Utika, ndërpreu punimet për rrethimin e qytetit... (Caes. Liber II, kap. 37).

Per eas se Catilina *credebat* **posse** servitia urbana **sollicitare**, **urbem incendere**, **viros** earum vel **adiungere** sibi vel **interficere**.

Përmes tyre, Katilina *shpresonte* që të **ngrinte** në këmbë skllëverit e Romës, **të digjte qytetin**, **të bashkonte bashkëshortët** e tyre rreth çështjes së tij ose, në të kundërt, **t'i vriste**. (Sal. kap. XXIV).

*Video* vos **gloriam** minime **appetere**.

*Shoh* se ju nuk e **dëshironi** aspak **lavdinë**.

*Audio* **te mihi** **maledicere**.

*Dëgjoj* se **ti flet** keq për mua.

## 2. Foljet e vendimit

Foljet *statuo*, *constituo*, *decerno* = vendos, përcaktoj, kanë zakonisht paskajoren e thjeshtë (domethënë pa kallëzore), nëse kryefjala e fjalisë së varur është e njëjtë me atë të fjalisë drejtuese; **ut** (ose *ne*) dhe lidhoren, nëse dy fjalitë kanë kryefjalë të ndyshme; gerundivin dhe paskajoren, nëse dëshirohet t'i jepet paskajores që vijon ideja e domosdoshmërisë (Tantucci 1992 : 354). Për shembull:

*Caesar in Haeduos* **proficisci statuit** (Caes.)

Çezari **vendosi që të nisej** drejt vendit të Eduitëve.

*Galli statuunt ut decem milia hominum in oppidum* **mittantur** (Caes.)

Galët **vendosën që të dërgoheshin** në qytet dhjetëmijë burra.

*Caesar statuit expectandam* (nënkuptohet esse) *classem* (Caes.)

Çezari **vendosi të presë** (= që duhej pritur) flotën.

Quam ob rem **defensionem** in novo consilio non *statui* **parare**.

Kështu, unë nuk *kam vendosur* **të përgatis një mbrojtje** në lidhje me vendimin tim të ri. (Sal. kap. XXXV).

### 3. Foljet komandoj, ndaloj, lejoj

*Iubeo* = komandoj; *veto* = ndaloj; *prohibeo* = ndaloj, dhe foljet *sino*, *patior* = lejoj, lë, ndërtohen me kallëzoren e personit që urdhërohet, ndalohet apo lejohet të bëjë diçka, dhe paskajoren (veprore) të foljes që varet nga to (Tantucci, 1992: 355).

**Milites Domitianos** sacramentum apud se **dicere iubet** atque eo die castra movet iustumque iter conficit...

Më pas **urdhëron ushtarët domicianë të betoheshin** për besnikëri ndaj tij dhe, po atë ditë, ngre fushimin, bën një udhëtim të zakonshëm... (Caes, liber I, kap. 24)

Caesar **Helvetios** in fines suos **reverti iussit** (Ces.)

Çezari i **urdhëroi Helvetët të ktheheshin** në territoret e tyre.

**Legatos** Caesar **discedere veturat** (Ces.)

Çezari i **kishte ndaluar legatët të largoheshin**.

### 4. Foljet sentiendi dhe declarandi, me ut (ne) dhe lidhoren

Folja **censeo** dhe **verba declarandi**: *dico, respondeo, scribo, nuntio, moneo, admonero, persuadeo* etj., kanë kallëzoren dhe paskajoren kur ndiqen nga një fjali dëftore, domethënë kur shprehet me to një konstatim i një fakti apo thjesht komunikim i një mendimi (= që një gjë është apo nuk është). Ndërsa nëse pas tyre vijon një fjali dëshirore, domethënë shprehet me to dëshira, vullneti, një urdhër (= që një gjë të bëhet apo të mos bëhet), kemi një **ut** apo **ne** dhe lidhoren (Tantucci 1992: 355). Për shembull:

**Responsum est Augusto centum solos dies (eum) victurum esse** (Svet.).

Augustit iu dha përgjigja se do të jetonte vetëm njëqind ditë.

*Deliberantibus Pythia respondit, ut moenibus ligneis se munirent* (Nep.)

Atyre që e konsultonin Pizia iu përgjigj që të mbroheshin me mure druri.

...atque ideo continuato nocte ac die itinere atque omnibus oppidis mutatis ad celeritatem iumentis ad Pompeium contendit, ut **adesse Caesarem nuntiaret**.

...duke udhëtuar pa pushim ditë e natë dhe duke ndërruar kuajt në të gjitha bujtinat për shpejtësi më të madhe, drejtua nga Pompeu që **ta lajmëronte se Çezari ishte afër**. (Caes, Liber III, kap. 11).

Duke qenë se disa nga foljet, në bazë të faktit që kanë njërin ndërtim apo tjetrin, ndryshojnë ndjeshëm kuptimin, po ju rreshtojmë kryesorët (Tantucci 1992: 356).

a) **Censeo**, në kuptimin e “mendoj, besoj, vlerësoj” (që një gjë është apo nuk është) ndërtohet me *kallëzoren* dhe *paskajoren*; në kuptimin e “propozoj, dekretoj” me **ut** (apo **ne**) dhe lidhoren. Për shembull:

Thrasylbulus **cives** civibus **parcëre** aequum *censebat* (Nep.) = Trasibuli *mendonte* se ishte e drejtë që **qytetarët t'i falnin** qytetarët.

M. Calidius **censebat ut** (= propozonte se) Pompeius in suas provincias **proficisceretur**. = Mark Kalidi **propozonte** që Pompeu **të nisej** te provincat e veta. (Caes, Liber I, kap. 2).

Nëse në shprehje është përfshirë ideja e domosdoshmërisë, kemi perifrashen pësore:

*Cato Carthaginem delendam esse censebat* = Katoni mendonte se duhej shkatërruar Kartagjena.

b) **Moneo** e **admoneo**, në kuptimin e “mbaj mend, them, vë re” (që një gjë është apo nuk është) ndërtohen me *kallëzoren* dhe *paskajoren*; në kuptimin e “nxit, këshilloj” (për të bërë diçka) me **ut** (ose **ne**) dhe lidhoren. Për shembull:

Caesar *monuit* **victoriam** in cohortium virtute **constare** = Çezari *kujtoi* se **fitorja qëndronte** në vlerën e oborreve. (Caes. Liber III, kap. 89).

*Caesar Dumnorigem monet, ut omnes suspiciones vitet* (Caes.) = Çezari **nxit** Dumnorixhin **të shmangë** çdo dyshim.

c) **Certior facio**, në kuptimin e “informoj, e bëj të vetëdijshme, rrëfej” (që një gjë është apo nuk është) ndërtohet me *kallëzore* dhe *paskajore*; ndërsa, në kuptimin e “qortoj, shtyj” (dikë të bëj diçka) me **ut** (ose **ne**) dhe lidhoren. Për shembull:

Interea *certior factus Iguium* Thermum praetorem cohortibus V **tenere, oppidum munire**, omniumque...

Ndërkohë, (Çezari) *informohet* se pretori Termi **kishte pushtuar Iguvin** me pesë kohorta, **kishte siguruar qytetin** dhe të gjithë ... (Caes. Liber I, kap. 12).

Varro cum itinere converso sese Italicam venturum praemisisset, *certior* ab suis *factus est* **praeclusas esse portas**.

Varroni ndërroi drejtim dhe dërgoi kasnecë në Italikë për të njoftuar mbërritjen e tij, kur *lajmërohet* prej njerëzve të vet se **portat ishin të mbyllura** (Caes. Liber II, kap. 20).

Caesar **certior factus est** (= u informua) *tres iam copiarum partes Helvetios flumen traduxisse*. = Çezari **u informua** se tri ushtri të Helvetëve **kaluan** lumin. (Caes).

Caesar *milites certiores facit, (ut) paulisper intermittērent proelium* (Caes.) = Çezari nxit ushtarët të ndërpresin për pak kohë luftimin.

## ✍ Shënim

Ndërtimi *accusativus cum infinitivo* haset edhe në fjalitë paskajore me vlerë kryefjalore (fjalitë e varura kryefjalore), sidomos në ndërtimet *bonum est, dignum est, iustum est*, etj. Për shembull:

*Iustum est pueros parentibus parere.*

*Është e drejtë që fëmijët t'u binden prindërve.*

*Notum est Teutam Illyriorum reginam fuisse.*

*Dihet se Teuta ka qenë mbretëreshë e ilirëve.*

Në ndërtimet *accusativus cum infinitivo* paskajorja mund të vendoset në kohë të ndryshme, por koha e kryerjes së veprimit nga ana e saj, siç e kemi thënë më lart, varet nga folja drejtuese. Pra mund të kemi njëkohësi (paskajore e tashme), parakohësi (paskajore e kryer) dhe paskohësi (paskajore e ardhme) (Terracina 2003: 49). Për shembull: (Qiriazati – Dishnica 1989: 286)

*Paskajore e tashme veprare dhe joveprare*

Video puerum epistulam scribere – shoh që djali shkruan letrën.

Video epistolam a puero scribi – shoh që letra shkruhet prej djalit.

*Paskajore e kryer veprare dhe joveprare*

Video puerum epistulam scripsisse – shoh që djali e ka shkruar letrën.

Video epistolam a puero scriptam esse – shoh që letra është shkruar prej djalit.

*Paskajore e ardhme veprare dhe joveprare*

Puto puerum epistulam scripturum esse – mendoj se djali do ta shkruajë letrën.

Puto epistolam a puero scriptum iri – mendoj se letra do të shkruhet prej djalit.

Siç shihet edhe nga shembujt ndërtimi *accusativus cum infinitivo* përdoret shpesh në gjuhën latine. Kuptimi i tij në shqipe jepet sipas rastit, nëpërmjet një fjalie të varur kundrinore ose kryefjalore me lidhëzat **që** ose **se**. Në përkthim duhet të kemi kujdes që kallëzorja e këtij ndërtimi të përkthehet me emërore (kryefjalë e fjalisë së varur), kurse paskajorja ka zakonisht ka kuptimin e kallëzuesit, përkthimi i të cilit duhet të përshtatet në vetë e numër me kryefjalën e saj. Gjithsesi në përkthimet letrare, për shkak të hapësirës që të krijon teksti, kallëzorja mund të përkthehet në shqipe edhe me kallëzore.

## Përfundim

Ndërtimi kallëzore me paskajore (*accusativus cum infinitivo*) paraqet në vetvete një fjali të varur kundrinore, në të cilën kryefjala logjike gjendet në kallëzore dhe folja shprehet me anë të paskajores. Ndërtimi *accusativus cum infinitivo* përdoret në rastet me fjalitë paskajore me vlerë kundrinore. Por rastet më të theksuara i kemi kur përdoren me: *Foljet e perceptimit; foljet e vendimit; foljet komandoj, ndaloj, lejoj; etj.*

Disa folje kur përdoren në ndërtimin *kallëzore me paskajore* kanë një kuptim të caktuar, ndërsa kur përdoren në ndërtimet me *ut* dhe *lidhoren*, ndryshojnë kuptim. Të tilla janë: folja *Censeo*, në kuptimin e “mendoj, besoj, vlerësoj” në ndërtimin *kallëzore me paskajore*, ndërsa merr kuptimin e “propozoj, dekretoj” në ndërtimin me *ut* dhe *lidhore*; *Moneo e admoneo*, në kuptimin e “mbaj mend, them, vë re” në ndërtimin *kallëzore me paskajore*, ndërsa merr kuptimin e “nxit, këshilloj” në ndërtimin me *ut* dhe *lidhore*, etj.

Në ndërtimet *accusativus cum infinitivo* koha e kryerjes së veprimit të shprehur nga paskajorja varet nga folja drejtuese. Pra mund të kemi njëkohësi (paskajore e tashme), parakohësi (paskajore e kryer) dhe paskohësi (paskajore e ardhme). Ndërtimi *accusativus cum infinitivo* përdoret shpesh në gjuhën latine. Kuptimi i tij në shqip jepet sipas rastit, nëpërmjet një fjalie të varur kundrinore ose kryfjalore me lidhëzat **që** ose **se**. Në përkthim duhet të kemi kujdes që kallëzorja e këtij ndërtimi të përkthehet me emërore (kryefjalë e fjalisë së varur), kurse paskajorja ka zakonisht ka kuptimin e kallëzuesit, përkthimi i të cilit duhet të përshtatet në vetë e numër me kryefjalën e saj.

## Bibliografi

- AKADEMIA e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (1997), *Gramatika e gjuhës shqipe, II*, Tiranë.
- CAESAR Caius Julius (2008), *De bello civili*, UTET, Torino.
- ÇELIKU Mehmet (2000), *Rreth studimit të formave të pashtjelluara në rrafshin dialektor*, SF 3-4, Tiranë.
- ÇELIKU Mehmet (2006), *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, Shblu, Tiranë.
- DEMIRAJ Shaban (1969), *Rreth disa problemeve të paskajores në gjuhën shqipe*, SF, 1, Tiranë.
- DOMI Mahir (1952), *Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa e dytë, sintaksa*, Tiranë.
- FRANJA Luigj (1995), *Paskajorja në gjuhën shqipe*, Hylli i Dritës, Nr. 3-4, Tiranë.
- GABINSKI (1967), *Lindja e paskajores si një proces gjuhësor ballkanik sekondar*, Leningrad.
- GHISELLI Alfredo, CONCIALINI Gabriella (2006), *Il nuovo libro di latino*, Laterza, Bari.
- GOSTURANI Xheladin (1994), *Format e pashtjelluara të foljes në të folmet e gegërishtes verilindore*, SF 1-4, Tiranë.
- LACAJ Henrik, FISHTA Filip (2004), *Fjalor latinisht-shqip*, Saraçi, Tiranë.
- LIKAJ Ethem, ÇABEJ Maklena (2010), *Morfologji e shqipes standarde*, Julvin, Tiranë.
- MANSAKU Seit (1982), *Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj*, SF, 1, Tiranë.
- MANSAKU Seit (1983), *Funksionet sintaksore të paskajores tek autorët e vjetër*, SF, 2, Tiranë.
- QIRIAZATI Kosta, DISHNICA Roza (1989), *Gjuha latine, II*, Shblu, Tiranë.
- QIRIAZATI Kosta, DISHNICA Roza (1990), *Ushtrime të gjuhës latine*, Shblu, Tiranë.
- RIZA Selman (2004), *Çështja e paskajores në shqipe*, Vepra 4, Prishtinë.
- SALLUSTIUS Caius Crispus, (2008), *Catilinae coniuratio*, Oscarmondadori, Milano.
- SAUSY Lucien (1977), *Grammaire Latine (complète)*, Fernand Lanore, Paris.
- SAVOIA Leonardo, MANZINI Maria (2003), *Pjesorja dhe paskajorja në të folmen e Shkodrës*, SF 3-4, Tiranë.
- TANTUCCI Vittorio (1992), *Urbis et orbis lingua*, Poseidonia, Bologna.
- TERRACINA Francesco (2003), *Verbi latini*, Tutti i verbi regolari e irregolari, Vallardi, Milano.
- VESELAJ Nuhi, (2000), *Paskajorja, çështje e shqipes standarde*, Dardania Sacra, Prishtinë.
- XHUVANI Aleksandër (1960), *L'infinitif en albanais*, Lingua Posnaniensis, VIII.
- XHUVANI Aleksandër (1980), *Pjesorja në shqipet; Paskajorja në shqipet*, Vepra I, Kombinati Poligrafik, Tiranë.

## Përmbledhje

Kallëzorja me paskajore (accusativus cum infinitivo) është një nga ndërtimet më interesante të gjuhës latine. Në një ndërtim të tillë kryefjala e fjalisë së pavarur vendoset në rasën kallëzore, ndërsa folja e fjalisë së varur është një paskajore. Ndërtimi accusativus cum infinitivo përdoret në gjuhën latine zakonisht në fjalitë me vlerë kundrinore. Gjithsesi, në këtë punim do të shohim se në cilat raste përdoret më tepër ky ndërtim, foljet nga të cilat varet etj. Në këto ndërtime paskajorja mund të vendoset në kohë të ndryshme, por koha e kryerjes së veprimit nga ana e saj varet nga folja drejtuese. Mund të kemi njëkohësi, parakohësi dhe paskohësi. Kuptimi i tyre në shqipe jepet sipas rastit: nëpërmjet një fjalie të varur kundrinore ose kryefjalore me lidhëzat që ose se. Gjatë trajtimit të kësaj çështjeje do të parashtrijmë edhe disa rregulla për sa i përket mënyrës së përkthimit të kallëzores me paskajore. Të gjitha rregullat do të shoqërohen me shembuj përkatës të marrë nga autorët latinë. Artikulli sjell ndihmesë në teorinë e përkthimit dhe përgjithësisht në gramatikën krahasimtare.

**Fjalë kyçe:** gramatikë, gjuhë latine, gjuhë shqipe, përkthim.

## Summary

The accusative with infinitive is one of the most interesting forms of the Latin language. The subject of the independent clause in such a structure, is put in the accusative case, whereas the verb of the dependent clause is an infinitive form. The accusative with infinitive is usually used in Latin in infinitive clauses, which play the role of an object. Anyway, in this article we will see in which cases this form is mostly used, the verbs depending on, etc. In such patterns, the infinitive can be put in different tenses, but the time of the action depends on the leading verb. So the action may occur before, simultaneously or after the time of that verb. According to the context their meaning in Albanian can be presented with a dependent clause which plays the role of a subject or an object with the conjunction "that". While treating this subject, we will also see some rules concerning the translation of the accusative with infinitive, because due to the space created in the text, there may be exceptions, which can't be skipped. All the rules will be associated with relevant examples taken from Latin authors. The article brings a contribution to the theory of translation and, more generally, to the contrastive grammar.

**Key words:** Albanian language, grammar, Latin language, translation.